



RAPORT VLERËSUES I OMBUDSMAN

Ankesë përsa i përket shërbimeve këshillimore të Korporatës Ndërkombëtare Financiare në Kosovë për Projektin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) numër #29107

Janar 2012

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë/Ombudsman

Korporata Financiare Ndërkombëtare
Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe
www.cao-ombudsman.org

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE	3
1. HYRJE.....	4
2. ANKESA	5
3. PROJEKTI	6
4. VLERËSIMI I CAO	6
3.1. Metodologjia	6
3.2. Vlerësimi i rezultateve.....	7

LISTA E SHKURTIMEVE

BIC	Qendra e Informacionit Bankar
CIEL	Qendra për Ligjin Ndërkombëtar Mjedisor
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
SPEK	Sindikata e Pavarur e Energjisë së Kosovës
MIGA	Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe
PSP	Pjesëmarrja e Sektorit Privat
SEIA	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Shoqëror

1. HYRJJE

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO) është një mekanizëm i pavarur i Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencisë së Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA) të Grupit të Bankës Botërore. CAO raporton direkt tek Presidenti i Grupit të Bankës Botërore mandati i të cilit është të ndihmojë në shqyrtimin e ankesave të njerëzve që preken nga projektet e mbështetura të IFC/MIGA në mënyrë të drejtë, objektive dhe konstruktive si edhe të përmirësojë efektet shoqërore dhe mjedisore të projekteve në fjalë.

Vlerësimi i CAO është ndërmarrë nga funksioni i Ombudsman i CAO. Qëllimi i vlerësimit të CAO është:(1) të sqarojë problemet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesi/t; (2) të grumbullojë informacion rreth këndvështrimit të palëve të tjera të interesuara se si ata e shikojnë situatën; dhe (3) të ndihmojë palët e tjera të interesuara të kuptojnë dhe vendosin nëse një zgjidhje e përbashkët është e mundur nëpërmjet procesit të ndihmës nga Ombudsman i CAO, ose nëse çështja duhet të transferohet tek funksioni i Përputhshmërisë së CAO për shqyrtimin e tyre.

Ky dokument është një dokument paraprak i pikëpamjeve të dëgjua dhe grumbulluara nga ekipi i CAO dhe shpjegimet e hapave të mëtejshëm varen nga ankuesit nëse ata duan të vazhdojnë të punojnë me Ombudsman i CAO ose preferojnë të transferohen tek funksioni i Përputhshmërisë CAO. *Ky raport nuk bën ndonjë gjykim për meritat e ankesës.*

Përsa i përket Udhëzimeve Operative të CAO¹, hapat që vijojnë janë ndjekur në mënyrë tipike në përgjigje të një ankesë të marrë:

Hapi 1: Njoftimi për marrjen e ankesës

Hapi 2: Vlerësimi nëse ankesa përmbush kriteret për shqyrtim: Përcaktimi i pranueshmërisë së ankesës për vlerësim nën mandatin e CAO (jo më shumë se 15 ditë punë)

Hapi 3: Vlerësimi i Ombudsman: Vlerësimi i problemeve dhe mbështetja e palëve pjesëmarrëse të interesuara të kuptojnë dhe përcaktojnë nëse një zgjidhje e përbashkët është e mundur nëpërmjet procesit të ndihmës nga Ombudsman i CAO, ose nëse çështja duhet të transferohet tek funksioni i Përputhshmërisë së CAO për vlerësimin e efektit shoqëror dhe mjedisor të Projektit të IFC/MIGA. Koha e vlerësimit mund të zgjasi në maksimum deri në 120 ditë pune.

Hapi 4: Ndihma në arritjen e marrëveshjes: Nëse procesi i Ombudsman të CAO vazhdon, kjo fazë përfshin fillimin e procesit të zgjidhjes së konfliktit (në mënyrë tipike bazohet ose fillohet me një Memorandum Mirëkuptimi dhe/ose pranim dypalësh në rregullat bazë midis tyre) nëpërmjet ndihmës/ ndërmjetësimit, gjetjes së përbashkët të fakteve, ose pranimi të proceseve të tjera rrugëzgjidhëse që çojnë drejt arritjes së marrëveshjes, ose mënyra të tjera që palët pranojnë të bien dakord për një qëllim të përshtatshëm. Objektiva madhore në mënyrat e zgjidhjes së problemit do të jetë të shqyrtojë problemet e ngritura në ankesë si edhe ndonjë çështje tjetër të konsiderueshme që ka lidhje me ankesën që ishte identifikuar gjatë vlerësimit të procesit të zgjidhjes së problemit në mënyrë që është e pranueshme për palët e prekura².

¹ Për më tepër detaje në rolin dhe punën e CAO, ju lutemi referohuni Udhëzimeve Operative te plota tek: <http://www.cao-ombudsman.org/about/whoweare/index.html>

² Kur palë të ndryshme në një projekt nuk janë në gjendje të zgjidhin problemet nëpërmjet procesit të bashkëpunimit brenda një kohë të përcaktuar, Ombudsman i CAO fillimisht do të kërkojë të ndihmojë palët e interesuara nëpërmjet ndërhyrjes së tij kur ato janë pa rrugedalje. Nëse marrëveshja është e pamundur, Ombudsman i CAO do të informojë palët e interesuara përfshirë këtu edhe stafin e IFC/MIGA, Presidentin dhe Bordin e Grupit të Bankës Botërore dhe publikun që Ombudsman i CAO e ka mbyllur ankesën dhe e transferon atë tek funksioni i Përputhshmërisë në CAO për vlerësim

OSE

Vlerësimi i Funkcionit të Përputhshmërisë/Kontrolli: Nëse një zgjidhje e përbashkët nuk është e mundur, funksioni i Përputhshmërisë së CAO do të fillojë një vlerësim ligjor të projektit në pyetje të IFC/MIGA rreth efekteve shoqërore mjedisore dhe do të vendosi nëse një kontroll i detajuar për përputhshmërinë e ndërhyrjes së projektit të IFC/MIGA është i merituar.

Hapi 5: **Monitorimi** dhe vazhdimi

Hapi 6: **Konkluzioni/** Mbyllja e çështjes

Mbas një rishikimi të kujdesshëm të ankesës së marrë në Gusht 2011 nga ankuesit të cilët kërkuan konfidencialitet, CAO në Shtator 2011 vendosi që të shqyrtojë ankesën që përmbushte tre kritere kryesore:

1. Ankesa ka lidhje me një projekt që IFC/MIGA është duke marrë pjesë, ose është duke konsideruar aktivisht.
2. Problemet e ngritura në ankesë kanë lidhje me mandatin e CAO-s të adresojë efektet mjedisore dhe/ose shoqërore të Investimeve të IFC/MIGA.
3. Ankuesi (ose ata të cilët kanë autoritetin të prezantojnë ankesën) mund të jetë prekur nëse efektet shoqërore dhe/ose mjedisore të ngritur në ankesë ndodhën.

Si rrjedhim, sipas Udhëzimeve Operative të CAO, Ombudsman i CAO filloi vlerësimin e problemeve dhe mundësisve për zgjidhjen e tyre në ankesë.

2. ANKESA

Në Gusht 2011, CAO mori një ankesë në të cilën njerëzit lokalë të prekur nga efektet e Projektit të IFC/MIGA kërkuan që identitetet e tyre të mbahen në konfidencialitet. Ankesa ishte e mbështetur nga Organizatat Lokale Jo Qeveritare Kosovare dhe Organizatat Jo Qeveritare Ndërkombëtare. Ankesa ngrinte probleme rreth efektit të privatizimit të divizionit të shpërndarjes dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) i vetmi shërbim elektrik publik shtetëror i Kosovës. Ankesa pohon midis të tjerave, problemet shoqërore dhe mjedisore në vazhdim në lidhje me procesin e privatizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës KEK:

- *Humbja e punësimit/ Shkurtimet:* Ekzistenca e mundësisë së humbjes të punësimit në shërbimin publik dhe më gjerësisht në sektorin energjetik si edhe në planet e pa mjaftueshme për shkurtimet dhe të drejtat e shoqatave.
- *Rritja e Tarifave:* Ekziston shqetësimi që heqja e subvencioneve qeveritare të energjisë do të bëjë energjinë elektrike të papërbalueshme për një pjesë të madhe të shoqërisë.
- *Vlerësimi Ligjor:* Studime të pamjaftueshme të efekteve shoqërore dhe mjedisore të Rolit Këshillimor të IFC dhe për pasojë efektit negativ në sektorin energjetik. Më konkretisht ankuesit pohojnë që projekti nuk është në përputhje me standartet përmbushëse të IFC. 1 (Vlerësimi Shoqëror dhe Mjedisor dhe Sistemet e Menaxhimit) dhe 2 (Puna dhe Kushtet e Punës).
- *Përhapja e informacionit:* Informacion i rëndësishëm nuk iu bë i njohur palëve të interesuara në kohën e duhur (rreziqet ekonomike, efektet mjedisore dhe shoqërore, rreziqet tek palët e treta, opsionet lehtësuese, etj.) dhe ankuesit pohojnë që projekti nuk është në përputhje me politikën e IFC në lidhje me përhapjen e informacionit.

- *Konsultimi me Komunitetin:* Konsultimi me Komunitetin duhej të ishte bërë me pjesëmarrje më të gjerë dhe të shumë anshme nëpërmjet vlerësimit dhe seleksionimit të projektit.

3. PROJEKTI³

Ky projekt i IFC i vjen në ndihmë Qeverisë së Kosovës për privatizimin e mundshëm të KEK, shërbimit publik energjetik shtetëror të vendit, nëpërmjet pjesëmarrjes së sektorit privat (PSP). Faza 1 rishikon mundësinë e prezantimit të PSP në rrjetin shpërndarës dhe funksionet e furnizimit të KEK. Në qoftë se faza 1 përcakton që PSP është i realizueshëm nga prespektiva e tregut dhe është fitimprurës për vendin, faza 2 do të prezantojë një proces transparent tenderi që të tërheqi një investitor privat me fondet e nevojshme dhe ekspertizë të zgjidhi dështimet operative të KEK (shumë punonjës, menaxhim i pamjaftueshëm, pajisje të vjetra- jashtë kohe) si edhe problemet financiare (në veçanti grumbullimi i tarifave të ulëta). Qëllimi është kompletimi i suksesshëm i procesit të tenderit me zgjedhjen e një operatori privat e me reputacion strategjik.

Ky projekt këshillimor shërbimesh është kategorizuar me rrisht mesatar, dhe me mundësi mesatare në lidhje me rreziqet mjedisore dhe shoqërore. Rreziqet e identifikuara janë të njohura që rrjedhin nga privatizimi i një shërbimi publik që i shërben të gjithë vendit dhe marrja me mend e rrisqeve të rritjes së larta të tarifave.

IFC po menaxhon një buxhet prej 2,022,508 dollarësh për këtë projekt.

4. VLERËSIMI I CAO

4.1. Metodologjia

Qëllimi i vlerësimit të CAO është të sqarojë problemet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesit, të mbledhi informacion në mënyrën se si palët e tjera të interesuara e shikojnë situatën, dhe të ndihmojë palët të kuptojnë dhe përcaktojnë nëse një zgjidhje e përbashkët është e mundur nëpërmjet procesit të ndihmës nga Ombudsman i CAO, ose nëse çështja duhet të transferohet tek funksioni i Përputhshmërisë së CAO për rishikimin e tyre. Ombudsman i CAO *nuk mbledh informacion që të bëjë një gjykim në meritat e ankesës.*

Vlerësimi i CAO i ankesës së KEK-KEDS konsistonte në:

- Rishikimin e dokumenteve të projektit
- Intervista, takime, dhe diskutime në group
- Mision në Kosovë

Ekipi i CAO-s bëri dy udhëtime në terren në Prishtinë, Kosovë në Nëntor 2011. Në përgatitje për udhëtimin dhe gjatë udhëtimeve në terren, ekipi i Ombudsman i CAO-s rishikoi dokumentet e projektit të IFC dhe takoi me ankuesit, skuadrën e projektit të IFC në Kosovë, përfaqësues qeveritarë Kosovarë që kanë lidhje me çështjen në fjalë si edhe me palë të tjera të interesuara. Më konkretisht u bënë intervista individuale dhe diskutime në grupe të vogla me përfaqësues nga:

- Qendra e Solidaritetit AFL-CIO
- Qendra e Informacionit Bankar [Bank Information Center] (BIC)
- Qendra për Ligjin Mjesdisor Nderkombetar [Center for Int'l Environmental Law] (CIEL)
- Deloitte Consulting
- Forumi për Iniciativat Qytetare (FIQ)

³ Informacioni i projektit këtu është siguruar nga IFC dhe nuk pasqyron ndonjë gjykim nga ana e CAO-s

- Sindikata e Pavarur e Energjisë së Kosovës (SPEK)
- Instituti për Studimet e Përparuara (GAP)
- Konfederata e Sindikates Ndërkombëtare (ITUC) / Sindikata Botërore
- Privatizimi i KEDS Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU)⁴
- Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
- Zyra e Rregullatorit Energjetik e Kosovës (ERO)
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- RIINVEST, Instituti për Hulumtime Zhvillimore
- TetraTech
- Agjensia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

4.2. Vlerësimi i rezultateve

Një numër i konsiderueshëm i palëve të interesuara përfshirë si IFC dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, konfirmuan gadishmërinë e tyre të angazhohen në procesin e bashkëpunimit të adresojnë problemet e ngritura në ankesë. Sidoqoftë, pas një diskutimi të hollësishëm të mandatit të CAO, funksioneve, shërbimeve, dhe proceseve, ankuesit njoftuan CAO që ata konsideruan interesat e tyre (dhe interesat e publikut Kosovar) do të shërbehen më mirë nga funksioni i Përputhshmërisë së CAO. Kështu që, ankesa do të transferohet tek funksioni i Përputhshmërisë së CAO për vlerësim, sipas Udhëzimeve Operative të CAO.

Gjatë vlerësimit ekipi i Ombudsman i CAO nuk identifikoi ndonjë problem tjetër ose ankesa mbi ato të ankesës kryesore që i përmbledhi në Seksionin 1 më sipër⁵.

⁴ Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) është një njësi teknike e menaxhimit të projektit që shërben gjithashtu si sekretariati teknik për Komitetin e Privatizimit. PIU raporton direkt tek Komiteti i Privatizimit dhe është ngarkuar të ekzekutojë përgjegjësitë ditore, menaxhon dhe mbikqyr zhvillimin e Projektit. Komiteti i Privatizimit i themeluar nga Vendimi Qeveritar numër 08/39 në 8 Tetor, 2008 është entitet publik qeveritar përgjegjës për Projektin dhe siguron që Projekti është zbatuar në mënyrë konsistente me Objektivat Qeveritare.

⁵ Ankuesit kërkuan gjithashtu që CAO të mbajë në konfidencialitet letrën origjinale të ankesës sepse në rast ekspozimi do të bëjë të njohur identitetet e tyre. Me lejen e ankuesve, shqetësimet dhe problemet e shprehura në ankesë janë përmbledhur në këtë Raport Vlerësimi Publik dhe gjithashtu u shpërndanë me palë të tjera të interesuara gjatë vlerësimit të CAO.